



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT

AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR
DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR TIRANË
ZYRA VENDORE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR RROGOZHINË

Nr. 814 Prot

Datë 02.10.2025

SHPALLJE PËR APLIKIM SI MËSUES KOORDINATOR TË KËSHILLIMIT TË KARRIERËS

Në mbështetje të ligjit nr.69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 99, datë 27.2.2019, "Për mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar" i ndryshuar, Urdhërit Nr. 463, datë 30.08.2024, "Për përcaktimin e kriterëve për miratimin e "Mësuesit koordinator për sigurimin e cilësisë" dhe të "Mësuesit koordinator të këshillimit të karrierës në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar" të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, shkresës Nr. 5367/3 prot., datë 04.09.2024, "Mbi zbatimin Urdhërit Nr. 463, datë 30.08.2024 "Për përcaktimin e kriterëve për miratimin e "Mësuesit koordinator për sigurimin e cilësisë" dhe të "Mësuesit koordinator të këshillimit të karrierës" në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar" të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, si dhe shkresës Nr 2521/1 datë 01.10.2025, të Agjencisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar, "Për plotësimin e vendeve të lira për mësuesit koordinator për sigurimin e cilësisë dhe mësuesit koordinator të këshillimit të karrierës"

Ju njoftojmë se shpallen procedurat e konkurrimit mësuesit koordinator të këshillimit të karrierës për shkollën 9-vjeçare Qamil Gjuzi dhe do të mbulojë shkollat 9-vjeçare Xhorxh Soros, Spille, Sterbeg, Lekaj, Haki Skuqi, Luz i Madh.

- A) Kushtet që duhet të plotësojë kandidati për mësues koordinator për këshillimin e karrierës:**
- a) Duhet të jetë pjesë e sistemit arsimor dhe të ketë 5 vite punë si mësues, ndër të cilat 3 vite si mësues në shkollën ku punon dhe aplikon për mësues koordinator të këshillimit të karrierës ose në shkollën me numër më të madh nxënësish.
 - b) Të ketë përfituar kategorinë "Mësues i kualifikuar" me rezultat "Shumë mire" ose "Shkëlqyeshëm". Avantazh përbën rezultati "Shkëlqyeshëm".
 - c) Të jetë vlerësuar në matjen e performancës vjetore të mësuesit me vlerësimin "Shumë mire" për dy vite radhazi.
 - d) Të ketë aftësi shumë të mira komunikimi dhe njohuri në fushën e aktiviteteve që mbështesin zhvillimin e talenteve të nxënësve, të cituara në vlerësimet periodike të mësuesit në shkollë apo certifikata në trajnime.
 - e) Të ketë njohuri të gjuhës angleze dhe aftësi shumë të mira kompjuterike.

B) Dokumentacioni që duhet të dorëzojë:

- a) Kërkesë me shkrim,
- b) Jetëshkrim,
- c) Kopje të diplomave dhe listës së notave,
- d) Librezë pune ose vërtetim pune,
- e) Kopje të certifikatës së kualifikimit të fundit,
- f) Vlerësimet e punës së dy viteve të fundit,
- g) Dëshmi të njohjes së gjuhës së huaj (anglisht),
- h) Çertifikatë apo dëshmi të njohurive të programeve kryesore kompjuterike,
- i) Certifikata, trajnime ose rekomandime që dëshmojnë njohuri në fushën e aktiviteteve që mbështesin zhvillimin e talenteve të nxënësve,
- j) Deklaratë për vërtetësinë e dokumentave,
- k) Deklaratë e konfliktit të interesit,
- l) Vetëdeklarim i gjendjes gjyqësore.

Afatet për zhvillimin e procedurave të konkurimit të kandidatëve për mësuesit koordinator të këshillimit të karrierës:

- Aplikimet për këtë pozicion bëhen prej datës 03.10.2025 deri 08.10.2025.
- Vlerësimi i dosjeve dhe shpallja e listës paraprake bëhet me datë 09.10.2025.
- Afati i ankimimit data 10.10.2025.
- Shqyrtimi i ankimeve ankimeve dhe shpallja e listës përfundimtare me pikët e dosjes data 13.10.2025.
- Shpallja e listës përfundimtare sipas rënditjes së pikëve, data 14.10.2025.

Kandidatët e interesuar duhet të dërgojnë dosjen me elementët e detyrueshëm në ZVAP Rrogozhinë.

DREJTOR

ALIME HOXHA

